

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: "Sh.A Posta Shqiptare" dhe "Komisionit të Prokurimit Publik"

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomike)

"ALBDESIGN PSP" SHPK

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

L51819005Q

Nuis/Nipt

Rruga "Çerçiz Topulli", objekti Nr.17, Kashar/Tiranë

Adresa

Tiranë

Shqipëri

N/A

Qyteti

Shteti

Kodi Postar / Posta

00355672000800

N/A

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

gm@albdesign.al

E-mail

Ervin Rroshi (Administrator)

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2023/07/27

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

N/A

N/A

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

ALBDESIGN PSP

Rr. Çerçiz Topulli, 17 - Kashar, Tiranë
NIPT: L51819005Q

Seksioni II. Informacion mbi procedurën

1. Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.

REF-75636-07-20-2023

2. Lloji i Procedurës

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë.

Procedurë e hapur (**mbi kufirin e lartë monetar**)

Procedurë e hapur e thjeshtuar

Procedurë e kufizuar

Procedurë konkurruese me negociim

Partneritet për inovacion

Dialog konkurrues

Procedurë me negociim me shpallje paraprake të njoftimit

Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës

Shërbim Konsulence

Kontratë e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në LPP

3. Autoriteti /Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Sh.A Posta Shqiptare

4. Vlera e përllogaritur e prokurimit

(Vlera e përllogaritur e kontratës/marrëveshjes kuadër) (shuma në shifra dhe fjalë)

41,477,281.00 Lekë (Dyzet e një milion e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë e një) Lekë pa Tvsh

5. Objekti i kontratës/Marreveshjes Kuadër
(Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marreveshje kuader).
“Blerje Shtypshkrime”

6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës
(Data (viti/muaji/dita)
2023/08/24

7. Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit
(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)
N/A

8. Data e nënshkrimit të kontratës
(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmëri të kontratës)
N/A

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligji 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”;

Vendimi nr. 285 datë 19.05.2021 i Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ;

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkonti pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

Në datën 21.07.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar" me objekt "Blerje Shtypshkrime" me REF-75636-07-20-2023 me fond limit 41,477,281.00 Lekë pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar më datë 24.08.2023 nga autoriteti kontraktor "Sh.A Posta Shqiptare".

Shoqëria jonë shfaqet në cilësinë e shoqërisë lider dhe të interesuar në realizimin e shërbimeve dhe furnizimin me mallrat objekt prokurimi, e për rrjedhojë kemi interes të drejtpërdrejtë për të marrë pjesë në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Pasi shqyrtuam dokumentet e procedurës së prokurimit, kriteret e vecanta të kualifikimit, specifikimet teknike të procedurës, gjykojmë se këto të fundit nuk janë hartuar në përputhje me ligjin "Për prokurimin Publik", dhe aktet nënligjore në zbatim të tij duke rënë ndesh me kuadrin ligjor në fuqi, pasi vlerësojmë se janë diskriminuese si dhe krijojnë paqartësi dhe mundësi keqinterpretimi.

Për rrjedhojë, paraqesim ankesën si më poshtë vijon:

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkelejt e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

I. MBI LEGJITIMITETIN

Në nenin 110 pika 1 të ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", parashikohet se: *"1.Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave nëdokumentet e tenderit.*

-Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë."

Në nenin 94 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar parashikohet se:

"1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedure prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

2. *Operatori ekonomik ankimues duhet të dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik.*

3. *Ankimuesi përdor formularin standard të ankesës, që përmban të paktën: emrin, adresën, adresën elektronike të ankimuesit, referencën e procedures konkrete, bazën ligjore, si dhe një përshkrim të shkeljes së pretenduar. Ankimuesi është i detyruar të bëjë pagesën e tarifës pranë*

Komisionit të Prokurimit Publik. Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Kur është e mundur, ankimit i bashkëlidhet një kopje e aktit, që kundërshtohet."

Sa më sipër, në cilësinë e shoqërisë së interesuar për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit, interesi i së cilës rrezikon të dëmtohet për shkak të kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij shoqëria jonë gëzon legjitimitet të drejtëpërdrejtë dhe aktiv për të paraqitur ankesë në këtë procedurë prokurimi.

Bazuar në nenin 111, pika 1 e ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", ku parashikohet se: "1.Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik.

Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.", ankesa është paraqitur njëkohësisht në autoritetin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në zbatim të rregullave të parashikuara në ligjin 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij dhe brenda afatit 10 ditor nga data e publikimit të procedurës së prokurimit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike duke u legjitimuar.

II. MBI ANKESËN

Pasi morëm në shqyrtim dokumentet e procedurës së prokurimit, kriteret e vecanta për kualifikim, specifikimet teknike si dhe formularin e sasisë dhe grafikut të lëvrimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, konstatojmë se nga ana e autoritetit kontraktor janë kryer shkelje në drejtim të hartimit të dokumenteve të procedurës së prokurimit duke rënë ndesh me ligjin 162/2020 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, duke krijuar paqartësi dhe mundësi keqinterpretimi nga ana e operatorëve ekonomikë si dhe mundësi abuzimi në procesin e vlerësimit të ofertave.

1. Në shtojcën 7 "*Kriteret e Vecanta të Kualifikimit*", "*Kapaciteti teknik*" të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se:

"2.3.6. Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi mostra/modele për zërat 1, 2, 4 – Shtypshkrime Sherbimi Bankar Financiar; dhe për zërat 1, 5, 6, 10, 17, – Shtypshkrime Sherbimi Postar, të përcaktuara në sasinë dhe grafikun e lëvrimit dhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Mosparaqitja e mostrave të kërkuara si dhe mospërputhja e tyre më specifikimet teknike është kusht për skualifikim."

Mostrat/modelet duhet të dorëzohen të futur në zarf jo transparent të mbyllur të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën e shoqërisë, në ditën dhe orën e hapjes së tenderit përpara Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Këto modele do të kontrollohen nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Mosparaqitja e këtyre modeleve në afatin e përcaktuar dhe jo sipas specifikimeve teknike është kusht për skualifikim.

SQARIM: Operatori ekonomik duhet të dorëzojë modelet përkatëse në përputhje me specifikimet teknike.

Në shtojcën 6 "Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit", të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, përcaktohet sasia dhe grafiku si më poshtë vijon:

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

<i>Nr.</i>	<i>Modeli</i>	<i>Pëshkrimi</i>	<i>Njësia matjes</i>	<i>Sasia</i>
<i>Shtypshkrime Shërbimi Financiar Bankar</i>				
1		Libër arke	Blok	10000
2	SP 7/A	Ditari i pagesave të urdhër pagesave postare	Blok	9000
3	SP 6	Ditari i arkëtimeve të urdhër pagesave postare	Blok	7500
4		Mandat pagese (3 kopje)	Blok	42000
5		Mandat arkëtimi (3 kopje)	Blok	45000
6		Rulon letër termike për fatura	Rulon	50000
7		Formular dërgese Eurogiro (3 kopje)	Blok	300
8		Fletë hyrje të pullave (3 kopje)	Blok	500
9		Fletë dalje të pullave (3 kopje)	Blok	500
10		Deklaratë doganore importi	Copë	1000
11		Deklaratë eksporti	Copë	1000
12		Deklaratë Bis Eksporti	Copë	2000
13		Deklaratë Bis Importi	Copë	2000
<i>Shtypshkrime Shërbimi Postar</i>				
1	SP 2	Regjistër i dëftesave të pranimit të objekteve postare zyrtare	bllok	500
2	P2	Listë dërgesë e objekteve të porositura (2 kopje)	bllok	4500
3	P 3 Re	Listë dorëzimi i dërgesave postare, kolipostare	Blllok	2500
4	P 6	Lajmërim Marrje	Fije	600000
5	P8	Regjistër dorëzimi i objekteve të porositura	Blllok	5000
6	CN 24	Formular proces-verbal për jashtë shtetit	Blllok	600
7	C 5	Lajmërim marrje për objektet me destinacion jashtë shtetit (ngjyrë portokalli)	Fije	30000
8	CN 08	Reklamacione për jashtë vendit	Fije	16000

9	P 9	Vëzhgesa për objekte postare dhe kolipostare	Bllok	500
10	P 15 e Re	Kartelë dërgimi koli e brendshme	Fije	14000
11	CN 15	Etiketë kthimi për objektet jashtë vendit (e kuqe)	Copë	120000
12	E 10	Etiketa E 10 (jeshile)	Copë	600000
13	CN 22	Deklaratë doganore për paketa	Copë	160000
14	CN 23	Deklaratë doganore për koli	Bllok	2200
15	CP 71	Kartë dërgimi për koli jashtë shtetit (3 kopje)	Bllok	1600
16		Fletë dalje për gazetat (3 kopje)	Bllok	5500
17	P 6/1	Dëftesë pranimi konfirmim marrje e objektit ekspres i brendshëm	Bllok	2000
18		Regjistër i dorëzimit të kolive të hyra nga jashtë shtetit	Bllok	1000
19	AV 8	Etiketa thesi EMS me percina	Copë	51000
20	E 2/1	Etiketa thesi për postë brenda vendit	Copë	155000
21	CN 35	Etiketa thesi ajrore ndërkombëtare percina (të kuqe)	Copë	50000
22	CN 36	Etiketa thesi SAL ndërkombëtare percina	Copë	35500
23	CP 83	Etiketa tokësore të verdha me percina	Copë	5100
24		Proces-verbal për dëmtim të objekteve të ardhura nga jashtë vendit	Bllok	2800
25		Etiketa adezive thesi (1*300)	Rulon	8500
26		Etikete adezive per barkod objekte postare (1*1000)	Rulon	10000
27	CN 23 për EMS	Dëftesë pranimi objekteve EMS me barkod EE-- --AL	Bllok	1400
28		Regjistër pranimi i objekteve postare të klasifikuara "sekret shtetëror"	Bllok	120
29	P 25 e RE	Listë dërgesa postare të klasifikuara "sekret shtetëror"	Bllok	1000
30	P3 e Re	Listëdorëzimi i pakove postare sekrete nga Qendra Tranzite për filialet e qyteteve	Bllok	200
<i>Shtypshkrime të tjera</i>				
1		Fletë udhëtimi automjeti	Copë	10000
2		Libër korespondence zyrtare (Protokoll)	copë	150
3		Fletë dalje për magazinën (3 kopje)	Bllok	2000
4		Fletë hyrje për magazinën (3 kopje)	Bllok	1000

5	Libra magazine	Bllok	400
---	----------------	-------	-----

Afatet e lëvrimit: Malli do te dorezohet brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve kalendarike nga dita e nenshkrimit te kontrates mes paleve.

Vendi i dorëzimit: Malli do te dorezohet ne magazine e Drejtorise se Posta Shqiptare sh.a. konform dokumentacionit ligjor dhe teknik te kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe te marre persiper ne oferte nga ofertuesi.”

Në nenin 2 të ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se:

“Qëllim” i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Në nenin 3 **“Parime të përgjithshme”** të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Në nenin 21 pika 1 **“Autoriteti ose enti kontraktor”** i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.”*

Në nenin 4 pika 38 gërma “b” të ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: **“Specifikime teknike”** janë: ...Në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuar dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.

Në nenin 36 të ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se:
“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në

dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose

specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për

mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo reference duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo

sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifitime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

Në nenin 77, pika 1 dhe 4 të ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: “1.Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe

personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 40 pika 6 gërma “a” e Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*

b) *fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*

c) *dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

Vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim si dhe specifikimeve teknike bëhet që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses dhe në përputhje me specifikimet teknike të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për

t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë, dhe mosdiskriminimit janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe në fazën e vlerësimit të tyre.

Në interpretimin teleologjik (qëllimit) të dispozitës së sipërcituar, qëllimi i vendosur nga ligjvënësi për paraqitjen e mostrave, është dhënia e mundësisë së autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nëse këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit.

Në lidhje me sa më sipër, në rastin konkret pasi morëm në shqyrtim dokumentat e tenderit, shtojcën 5 "*Formulari i Specifikimeve Teknike*", shtojcën 6 "*Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvimit*", si dhe dokumentin e emërtuar "*Skanime shtypëshkrime 2023*", konstatojmë se në hartimin e këtyre dokumentave nga autoriteti kontraktor ka mangësi të dhënash duke krijuar në këtë mënyrë konfuzion për operatorët ekonomikë si dhe mundësi interpretimi në procesin e vlerësimit të ofertave.

Në rastin konkret pasi morëm në shqyrtim dokumentat standarte të tenderit, shtojcën 5 "Formulari i Specifikimeve Teknike", shtojcën 6 "Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit", si dhe dokumentin e emërtuar "Skanime shtypëshkrimet 2023", konstatojmë se në hartimin e këtyre dokumentave nga autoriteti kontraktor ka mangësi pasi mungojnë modele të skanuara për artikujt për të cilët parashikohet dorëzimi i mostrave për efekt vlerësimi dhe më konkretisht për artikullin me numër rendor 1 "Regjistër i dëftesave të pranimit të objekteve postare zyrtare", me numër rendor 5 "Regjistër dorëzimi i objekteve të porositura", me numër rendor 6 "Formular proces-verbal për jashtë shtetit", me numër rendor 10 "Kartelë dërgimi koli e brendshme" dhe me numër rendor 17 "Dëftesë pranimi konfirmim marrje e objektit ekspres i brendshëm" në grafikun e lëvrimit të "Shtypshkrime Sherbimi Postar" (bazuar në shtojcën 6 "Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit).

Në lidhje me sa më sipër, vlerësojmë se kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e mostrave nga operatorët ekonomikë me qëllimin e verifikimit të kapaciteteve të nevojshme për të prodhuar produktet objekt prokurimi si dhe të verifikimit të përputhshmërisë të mostrave të dorëzuara me specifikimet teknike të dhëna në dokumentet e tenderit, duhet të shoqërohet me **file për shtyp** për mostrat e përcaktuara në kërkesën për kualifikim të dokumenteve të tenderit në të cilat duhet të bazohen operatorët ekonomikë për të realizuar mostrat e kërkuara, por në rastin konkret konstatojmë se operatorëve ekonomikë nuk i janë vënë në dispozicion **file për shtyp** për artikujt e sipër cituar, duke krijuar në këtë mënyrë paqartësi për operatorët ekonomikë dhe mundësi për keqinterpretim në momentin e vlerësimit të mostrave të dorëzuara.

Sa më sipër, vlerësojmë se specifikimet teknike duhet të përfshijnë edhe **file për shtyp** (modele të skanuara) për të gjithë mostrat e përcaktuara në kërkesën për kualifikim të dokumenteve të tenderit, modele të cilat të cilat duhet të jenë sa më të sakta dhe të

krijojnë ide sa më të qarta të jetë e mundshme në mënyrë të tillë që të mos shkaktojnë konfuzion tek operatorët ekonomikë në momentin e përgatitjes së ofertës dhe në të njëjtën kohë të evitohen hapësirat për interpretim në momentin e vlerësimit.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin Nr.1/2021, datë 29.04.2021 në të cilin është shprehur se: “...për sa kohë në kriterin kualifikues të përcaktuar në Shtojcën 8, pika 2.3.6 të dokumenteve të tenderit është përcaktuar se: “Mosparaqitja e mostrave të kërkuara si dhe mospërputhja e tyre me specifikimet teknike është kusht për skualifikim.”, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e mostrave të sipërpërmendura nga ofertuesit është vërtetimi se subjektet ofertuese kanë kapacitetet e nevojshme për të prodhuar produktet objekt prokurimi sipas specifikimeve teknike të dhëna në dokumentet e tenderit, por nga ana tjetër autoriteti kontraktor referuar përcaktimeve të nenit 23, pika 4, të LPP-së, gjykonse autoriteti kontraktor ka detyrimin që të garantojë ofertuesit që specifikimet teknike (ku përfshihen modele) të jenë të sakta për t’u dhënë ofertuesve një ide të qartë për përgatitjen e ofertës, si dhe nga përshkrimi i mallrave objekt prokurimi të dalin edhe kërkesat nga pikëpamja estetike dhe për më tepër të garantohet krahasueshmëria e mostrave të dorëzuara me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor, prandaj në rastin konkret pretendimet e ankimuesve qëndrojnë. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor duhet t’u vërë në dispozicion ankimuesve file për shtyp për mostrat e përcaktuara në kërkesën për kualifikim të pikë 2.3.6, të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit në të cilat duhet të bazohen për të realizuar mostrat e kërkuara.”

Sa më sipër kërkojmë, që autoriteti kontraktor të vendosë në dispozicion të operatorëve ekonomikë file për shtyp (modele të skanuara) për të gjithë mostrat e përcaktuara në kërkesën për kualifikim.

2. Në shtojcën 5 "Formulari i Specifikimeve Teknike" të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar:

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

SPECIFIKIME TEKNIKE

TË PËRBASHKËTA:

1. Të shtypet me letër Ofset.
2. Peshë e letres 60 +/- 2gr/m² (të vecantat të specifikuara sipas listës).
3. Bardhësia mbi 80%.



4. Të jenë me logon e Posta Shqiptare Sh.A
5. Dimensionet dhe ngjyra e shkrimit është detajuar më poshtë.
6. Amballazhi i blloqeve në lidhje me 25 blloqe secila.
7. Blloqet do të jenë të mbështjella me kapak kartoni 200-250gr/m² dhe emërtimi i ngjitur në kapak.

TË VEÇANTA

Nr.	Modeli	Emërtimi	Specifikimet teknike	Njësia matjes
		Shtypshkrime Shërbimi Financiar Bankar		
1		Libër arke	<ul style="list-style-type: none"> – Bllok me përmasa 200 x 280 mm – Gjerësia e rreshtit 5 mm – Kapur me kapse në pjesën e sipërme – Blloqe me 100 fletë <i>numëri i fletëve (50x2) me dy kopje</i> – Kopja e parë ngjyrë e bardhë 	Bllok

			<ul style="list-style-type: none"> - Kopja e dytë ngjyrë rozë - Me kapak kartoni 	
2	SP 7/A	Ditari i pagesave urdhër pagesave postare të	<ul style="list-style-type: none"> - Blloku me 100 fletë Format A4 (50x2) me dy kopje - Gjerësia e rreshtit 10 mm - Shtypur në një anë - Blloku të jetë me ngjitje në anësoren e majtë me përformim për lehtësi shkëputje. - Kapaku me karton - Kopja e parë ngjyrë e bardhë - Kopja e dytë ngjyrë e verdhë 	Blok
3	SP 6	Ditari i arkëtimeve të urdhër pagesave postare të	<ul style="list-style-type: none"> - Blloku me 100 fletë Format A4 përmasa 21 cm x 29.7 cm, numëri fletëve (50x2) me dy kopje - Gjersia e rreshtit 10 mm - Shtypur në një anë - Blloku të jetë me ngjitje në anësoren e majtë me përformim për lehtësi shkëputje. - Kapaku me karton - Kopja e parë ngjyrë e bardhë - Kopja e dytë ngjyrë e verdhë 	Blok
4		Mandat pagese kopje) (3	<ul style="list-style-type: none"> - Blloku me 99 fletë (3x33) me përmasa 105x140 mm - Letër vetkopjuese me tre kopje me ngjyra të ndryshme - Blloku të jetë me ngjitje në anësoren e majtë me karton për mbështetje dhe me përforim - Të jenë me numër serial duke filluar nga 0000001 e në rritje 	Blok
5		Mandat arkëtimi kopje) (3	<ul style="list-style-type: none"> - Blloku me 99 fletë (3x33) me përmasa 105x140 mm - Letër vetkopjuese me tre kopje me ngjyra të ndryshme - Blloku të jetë me ngjitje në anësoren e majtë me karton për mbështetje dhe me përforim - Të jenë me numër serial duke filluar nga 0000001 e në rritje 	Blok
6		Rulon termike për fatura letër	<ul style="list-style-type: none"> - Përmasat: 3e1/8" x 230' (7.9cm x 70.1m) - Ngjyrë e bardhë - Indikator që lajmëron përfundimin e letrës - 10+ vjet jetëgjatësia e imazhit të printuar për arsye arkivimi - I përshtatshëm për printera termik, Diametri i rulonit nën 	Rulon

			80mm – Trashësia e letrës 48g/m ² – Bardhësia ≥ 80% – Relievi/poroziteti i sipërfaqes së letrës ≥ 350 s	
7	Formular dërgese Eurogiro (3 kopje)		– Blloku me 99 fletë (3x33) Format A4 – Gjerësia e rreshtit të jetë 10 mm – Letër vetkopjuese me tre kopje me ngjyra të ndryshme të dallueshme – Blloku të jetë me ngjitje në pjesën e sipërme me karton për mbështetje dhe me përformim për të realizuar shkëputjen – Të jenë me numër serial duke filluar nga 0000001 e në rritje	Blok
8	Fletë hyrje të pullave (3 kopje)		– Bllok me 99 fletë 33x3, format A4 – Letër vetkopjuese në tre kopje me ngjyra të ndryshme me numër serie – Blloku të qepet në anën e sipërme me kapse metalike – Kapak Kartoni	Blok
9	Fletë dalje të pullave (3 kopje)		– Bllok me 99 fletë 33x3, format A4 – Letër vetkopjuese në tre kopje me ngjyra të ndryshme me numër serie – Blloku të qepet në anën e sipërme me kapse metalike – Kapak Kartoni	Blok
10	Deklaratë doganore importi		– Format me permasa 30cmx24cm, leter vetkopjuese – Leter traktor me 5(pesë) kopje – Me biosje ne të dy anet dhe ne fund te formatit per lehtësi shkeputje te jete e perforuar. – Shenje dalluese e formatit ne anen e djathte vije e nderprere me ngjyra te ndryshme vetem ne 4 (kater) kopjet e fijos, – Permbajtja e formatit ne ngjyre te gjelber ne te 5 (pese) kopjet, – Permbajtja e formatit ne te 5 (pese) kopjet ne perputhje me Kodin Doganor te Republikes se Shqiperise, Neni 163, Aneksi B - 01 – Paketimi ne kuti me 500 fije (me permbajtje 5 kopje)	Copë
11	Deklaratë eksporti		– Format me permasa 30cmx24cm, leter vetkopjuese – Leter traktor me 5(pesë) kopje	Copë

			<ul style="list-style-type: none"> - Me birosje ne te dy anet dhe ne fund te formatit per lehtesi shkeputje te jete e perforuar. - Shenje dalluese e formatit ne anen e djathte vije e panderprere me ngjyra te ndryshme vetem ne 4 (kater) kopjet e fijos, - Permbajtja e formatit ne ngjyre te gjelber ne te 5 (pese) kopjet, - Permbajtja e formatit ne te 5 (pese) kopjet ne perputhje me Kodin Doganor te Republikes se Shqiperise, Neni 163, Aneksi B - 01 - Paketimi ne kuti me 500 fije (me permbajtje 5 kopje) 	
12	Deklaratë Bis Eksporti		<ul style="list-style-type: none"> - Format me permasa 30cmx24cm, leter vetkopjuese - Leter traktor me 5(pesë) kopje - Me birosje ne te dy anet dhe ne fund te formatit per lehtesi shkeputje te jete e perforuar. - Shenje dalluese e formatit ne anen e djathte vije e panderprere me ngjyra te ndryshme vetem ne 4 (kater) kopjet e fijos, - Permbajtja e formatit ne ngjyre te gjelber ne te 5 (pese) kopjet, - Permbajtja e formatit ne te 5 (pese) kopjet ne perputhje me Kodin Doganor te Republikes se Shqiperise, Neni 163, Aneksi B - 01 - Paketimi ne kuti me 500 fije (me permbajtje 5 kopje) 	Copë
13	Deklaratë Bis Importi		<ul style="list-style-type: none"> - Format me permasa 30cmx24cm, leter vetkopjuese - Leter traktor me 5(pesë) kopje - Me birosje ne te dy anet dhe ne fund te formatit per lehtesi shkeputje te jete e perforuar. - Shenje dalluese e formatit ne anen e djathte vije e nderprere me ngjyra te ndryshme vetem ne 4 (kater) kopjet e fijos, - Permbajtja e formatit ne ngjyre te gjelber ne te 5 (pese) kopjet, - Permbajtja e formatit ne te 5 (pese) kopjet ne perputhje me Kodin Doganor te Republikes se Shqiperise, Neni 163, Aneksi B - 01 - Paketimi ne kuti me 500 fije (me permbajtje 5 kopje) 	Copë
		<i>Shtypshkrime Shërbimi Postar</i>		

1	SP 2	Regjistër i dëftesave të pranimit të objekteve postare zyrtare	-Bllok me 100 fletë me përmasa 170x210mm -gjerësia e rreshtit 7mm, 8 kollona - Me kapak kartoni, e kapur me kapse në pjesën anësore majtas - Ngjyra e bardhë, shkrimi i zi	bllok
2	P2	Listë dërgesë e objekteve të porositura (2 kopje)	-Bllok me 100 fletë me përmasa 210x280mm - letër vetkopjuese me dy kopje: kopja e parë ngjyrë të bardhë; kopja e dytë ngjyrë të verdhë - gjerësia e rreshtit 8mm - blloku të jetë me ngjitje në pjesën e sipërme me karton për mbështetje dhe me perforim për të realizuar shkëputjen.	bllok
3	P 3 Re	Listë dorëzimi i dërgesave postare, kolipostare	-bllok me 100 fije, - letër vetkopjuese me dy kopje: kopja e parë ngjyrë të bardhë; kopja e dytë ngjyrë të verdhë -me përmasa 170x230mm - blloku të jetë me ngjitje në pjesën e sipërme me karton për mbështetje dhe me perforim për të realizuar shkëputjen.	Bllok
4	P 6	Lajmërim Marrje	-në fije me përmasa 150x110mm -shtypur në të dy anët, sfondi i bardhë shkrimi zi -paketimi 100 copë	Fije
5	P8	Regjistër i dorëzimi i objekteve të porositura	-Bllok me 100 fletë me përmasa 210x290mm - letër vetkopjuese me dy kopje: kopja e parë ngjyrë të bardhë; kopja e dytë ngjyrë të verdhë - gjerësia e rreshtit 8mm - blloku të jetë me ngjitje në pjesën e sipërme me karton për mbështetje dhe me perforim për të realizuar shkëputjen.	Bllok
6	CN 24	Formular proces-verbal për jashtë shtetit	- bllok me letër vetkopjuese me dy kopje -përmasat 210x297mm - Blloku të jetë me ngjitje në pjesën e sipërme me karton për mbështetje dhe me performim për të realizuar shkëputjen.	Bllok
7	C 5	Lajmërim marrje për objektet me destinacion jashtë shtetit (ngjyrë portokalli)	-ne fije karton 200gr/m2, me përmasa 160x105mm -fusha me ngjyre portokalli -shkrimi me te zeze -shtypur ne te dy anet -paketimi 100 cope ne pako	Fije
8	CN 08	Reklamacion e për jashtë vendit	-format A4 -fusha e bardhë shkrimi i zi -paketuar në pako 500 fletë	Fije
9	P 9	Vëzhgesa për objekte postare dhe kolipostare	-bllok me 99 fletë, me përmasa 170x210 mm -gjerësia e rreshtit 7 mm - letër vetkopjuese me tre kopje: kopja e parë ngjyrë të bardhë; kopja e dytë ngjyrë të verdhë, kopja e tretë ngjyrë	Bllok

			rozë - sfondi i bardhë shkrimi zi - Blloku të jetë me ngjitje në pjesën e sipërme me karton për mbështetje dhe me performim për të realizuar shkëputjen.-	
10	P 15 e Re	Kartelë dërgimi koli e brendshme	Ne fije me permasa 90*175 mm -Shtypur nga të dyja anët -e paketuar ne pako 100 cope -materiali karton me peshë 250gr/m2, ngjyra e bardhë dhe shkrimi me ngjyrë të zezë	Fije
11	CN 15	Etiketë kthimi për objektet jashtë vendit (e kuqe)	-Shkrimi me ngjyre te zeze -Fusha me ngjyre te kuqe -Permasat 52x52mm -Paketimi 100 cope ne pako -me ngjitje	Copë
12	E 10	Etiketa E 10 (jeshile)	-Shkrimi me ngjyrë të zezë -Fusha me ngjyrë jeshile -Përmasat 32x50mm -Paketimi 100 copë në pako. -me ngjitje	Copë
13	CN 22	Deklaratë doganore për paketa	- etikete me permasa 74x105 mm me leter adezive me ngjyre jeshile -me shkrim ngjyre te zeze -me paketim ne pako 500 cope	Copë
14	CN 23	Deklaratë doganore për koli	-bllok me 100 fletë, me permasa 210x148 mm - letër vetkopjuese me tre kopje: kopja e parë ngjyrë të bardhë; kopja e dytë ngjyrë të verdhë, - sfondi i bardhë, shkrimi i zi - Blloku të jetë me ngjitje në pjesën anësore me karton për mbështetje dhe me performim për të realizuar shkëputjen	Bllok
15	CP 71	Kartë dërgimi për koli jashtë shtetit (3 kopje)	-bllok me 99 fletë, me permasa 210x148 mm - letër vetkopjuese me tre kopje: kopja e parë ngjyrë të bardhë; kopja e dytë ngjyrë të verdhë, kopja e tretë ngjyrë rozë - sfondi i bardhë, shkrimi i zi - Blloku të jetë me ngjitje në pjesën anësore me karton për mbështetje dhe me performim për të realizuar shkëputjen	Bllok
16		Fletë dalje për gazetat (3 kopje)	- bllok me 99 fletë, me permasa 205x145 mm - letër vetkopjuese me tre kopje: kopja e parë ngjyrë të bardhë; kopja e dytë ngjyrë të verdhë, kopja e tretë ngjyrë rozë -Përmbajtja sipas modelit bashkëngjitur - sfondi i bardhë, shkrimi i zi - Blloku të jetë me ngjitje në pjesën anësore me karton për mbështetje dhe me performim për të realizuar shkëputjen	Bllok

17	P 6/1	Dëftesë pranimit konfirmim marrje objektit ekspres brendshëm	<ul style="list-style-type: none"> - bllok me 99 fletë, me permasa 220x100 mm - letër vetkopjuese me tre kopje: kopja e parë ngjyrë të bardhë; kopja e dytë ngjyrë të verdhë, kopja e tretë ngjyrë rozë -Përmbajtja sipas modelit bashkëngjitur - sfondi i bardhë, shkrimi i zi - Blloku të jetë me ngjitje në pjesën anësore me karton për mbështetje dhe me perforim për të realizuar shkëputjen 	Bllok
18		Regjistër i dorëzimit të kolive të hyra nga jashtë shtetit	<ul style="list-style-type: none"> - bllok me permasa 290 x 210 mm -gjerësia e rreshtit 7 mm -bllloqe 100 flete -me kapse metalike në anën e majtë -me kapak kartoni 	Bllok
19	AV 8	Etiketa thesi EMS me percina	<ul style="list-style-type: none"> -Me karton me dy ngjyra blu dhe portokalli 300gr/m2 e celofonuar mat. -Me permasa 155x90mm. -Me birë me perçinë në anën e majtë -paketimi 500 copë. 	Copë
20	E 2/1	Etiketa thesi për postë brenda vendit	<ul style="list-style-type: none"> -Me karton të bardhë 250gr/m2 -Me permasa 190x90mm -Me 2 bira në anën e majtë në të njëjtën lartësi -paketimi 500 copë 	Copë
21	CN 35	Etiketa thesi ajrore ndërkombëtare percina (të kuqe)	<ul style="list-style-type: none"> -Me karton me ngjyrë të kuqe, 300gr/m2 e celofonuar mat. -Me permasa 155x90mm -Me Birë me perçinë në anën e majtë, me diametër 7 mm. -paketimi 500 copë 	Copë
22	CN 36	Etiketa thesi SAL ndërkombëtare perçina	<ul style="list-style-type: none"> -Me karton me ngjyrë të bardhë 300gr/m2 e celofonuar mat. -Me permasa 130 x 90mm -Me Birë me perçinë në anën e majtë -paketimi 500 copë 	Copë
23	CP 83	Etiketa tokësore të verdha me precina	<ul style="list-style-type: none"> -Me karton me ngjyrë të verdhë 300gr/m2 e celofonuar mat. -Me permasa 130 x 90mm -Me Birë me perçinë në anën e majtë -paketimi 500 copë 	Copë
24		Proces-verbal për dëmtim të objekteve të ardhura nga jashtë vendit	<ul style="list-style-type: none"> - bllok me 100 fletë, me permasa 150x200 mm - letër vetkopjuese me dy kopje: kopja e parë ngjyrë të bardhë; kopja e dytë ngjyrë të verdhë -Përmbajtja sipas modelit bashkëngjitur - sfondi i bardhë, shkrimi i zi - Blloku të jetë me ngjitje në pjesën e sipërme me karton për mbështetje dhe me perforim për të realizuar shkëputjen 	Bllok
25		Etiketa adezive thesi (1*300)	<ul style="list-style-type: none"> - letër termike adezive me permasa 130x80 për printer ZebraGK420Dtm - të paketuara në rulonë me 300 copë me vendosje të etiketës 	Rulon

			vertikalisht në rulon (përmasa më e madhe), me distance 5 mm nga njëra – tjetra, -letër e cilësisë së lartë e bardhë -të ngjitet në mënyrë solide (sipas mostrës)	
26		Etikete adezive barkod objekte postare (1*1000)	- letër termike adezive me përmasa 65x25 mm, për printer ZebraGK420Dtm - të pakeluar në rulonë me 1000 copë, të vendosura horizontalisht (nga përmasa më e madhe) dhe në distance 5 mm nga njëri tjetri. -letër e cilësisë së lartë, e bardhë. -të ngjitet në mënyrë solide (sipas mostrës)	Rulon
27	CN 23 për EMS	Dëftesë pranimit objekteve EMS me barkod EE-- --AL	-do të jetë me logon e shërbimit EMS, gërma blu, vizat duhet të jenë portokalli -barkodi i këtij formulari është i përbërë nga 13 karaktere p.sh EE123456789AL ku -EE-janë karaktere që përfaqësojnë shërbimin EMS -AL-janë karaktere që përcaktojnë vendin e origjinës -Numrat janë unik, 9 numra të gjeneruara sipas algoritmit -ky formular do të ketë në pjesën e prapme instruksionet e nevojshme për klientët. -këto instruksione i keni në pjesën e prapme të formularit bashkëlidhur. -përmasat e formularit do të jenë 210 x148 mm -blloku duhet të ketë 100 fletë (50 formulare, secili me 2 kopje) kapaku të jetë kartoni me ngjitje në krahun e majtë. -kopja e parë e formularëve duhet të jetë e bardhë me gërma të zeza, e dyta të jetë ngjyrë jeshile dhe vetkopjuese.	Bllok
28		Regjistër pranimit objekteve postare të klasifikuara “sekret shtetëror”	-blloku me 100 fletë me përmasa 210x290mm -Me kapak kartoni dhe qepje në anën e majtë -gjerësia e rreshtit 8 mm -Shkrimi nga të dy anët	Bllok
29	P 25 e RE	Listë dërgesa postare të klasifikuara “sekret shtetëror”	-blloku me 99 fletë, me letër vetëkopjuese në tre kopje, ngjyrë të bardhë. - përmasa 170x210mm -gjerësia e rreshtit 8 mm - Blloku të jetë me ngjitje në pjesën e sipërme me karton për mbështetje dhe me performim për të realizuar shkëputjen.	Bllok
30	P3 e Re	Listëdorëzimi i pakove postare sekrete nga	-blloku me 100 fletë me përmasa 210x290mm, me letër vetëkopjuese në dy kopje, ngjyrë të bardhë. -gjerësia e rreshtit 8 mm, - Blloku të jetë me ngjitje në pjesën anësore me karton për	Bllok

	Qendra Tranzite për filialet e qyteteve	mbështetje dhe me performim për të realizuar shkëputjen.	
	Shtypshkrime të tjera		
1	Fletë udhëtimi automjeti	– Flete me permasa 295 x 420 me palosje me permasa – E shtypur nga te dy anet – Paketuar me 500 cope	Copë
2	Libër korespondence zyrtare (Protokoll)	– Bllok me përmasa 340 x 240 mm me palosje në hapje përmasa 490 x 320 – Fusha e bardhë shkrimi i zi – Me rreshta dhe kollona – Me kapak Kartoni	Copë
3	Fletë dalje për magazinën (3 kopje)	– Me letër vetkopjuese me tre kopje me ngjyra të dallueshme – Bllok me 99 fletë (33 x 3). – Përmasa 220 x 190mm – Me numër serial me ngjyrë të kuqe – Blloku të qept në anën e sipërme me dy kapse metalike me përforim	Bllok
4	Fletë hyrje për magazinën (3 kopje)	– Me letër vetkopjuese me tre kopje me ngjyra të dallueshme – Bllok me 99 fletë(33 x 3). – Përmasa 220 x 190mm – Me numër serial me ngjyrë të kuqe – Blloku të qepet në anën e sipërme me dy kapse metalike me përforim	Bllok
5	Libra magazine	– Bllok me permasa 230 x 170 mm njëra anë me qepje në mes(460 x 340) – Bllok me 100 fije – Kapak me karton – Me shkrim nga të dy anët	Bllok

Në nenin 4 pika 38 gërma "b" të ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", parashikohet se: **"Specifikime teknike"** janë: ...Në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike,

përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.

Në nenin 36 të ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", parashikohet se:
"1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

7. *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

8. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

d) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

e) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin epunëve ose përdorimin e produkteve;

f) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo reference duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

9. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

10. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u

referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

11. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor."

Vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim si dhe specifikimeve teknike bëhet që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses dhe në përputhje me specifikimet teknike të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë, dhe mosdiskriminimit janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe në fazën e vlerësimit të tyre.

Në lidhje me sa më sipër, në rastin konkret pasi morëm në shqyrtim dokumentat e

tenderit, shtojcën 5 "Formulari i Specifikimeve Teknike" konstatojmë që në hartimin e specifikimeve teknike ka specifikime diskriminuese të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në procedurën e prokurimit objekt ankimi si dhe ka kërkesa të paqarta të cilat lënë hapësira për interpretim në momentin e vlerësimit.

Në rastin konkret, në lidhje me kërkesën e parashikuar në "Formulari i Specifikimeve Teknike", në seksionin "Të përbashkëta" ku parashikohet se:

"Të shtypet me letër Ofset.

2.Pesha e letrës 60 +/- 2gr/m² (të vecantat të specifikuara sipas listës).

3.Bardhësia mbi 80%.

4.Të jenë me logon e Posta Shqiptare Sh.A

5.Dimensionet dhe ngjyra e shkrimit është detajuar më poshtë.

6.Amballazhi i blloqeve në lidhje me 25 blloqe secila.

7.Blloqet do të jenë të mbështjella me kapak kartoni 200-250gr/m² dhe emërtimi i ngjitur në kapak."

vlerësojmë se:

I. Në lidhje me kërkesën se "*pesha e letrës duhet të jetë 60 +/-2gr/m²*" vlerësojmë se është një kërkesë e cila lë vend për interpretime pasi:

1. Në vlerësimin tonë dhe nisur nga raste të mëparshme të ngjashme diferenca e lejuar e gramaturës së letrës nuk duhet të jetë në gramë si në rastin konkret që është +/- 2 gr/m² por duhet të përcaktohet në përqindje, kjo pasi edhe në rast të kryerjes së testimeve për letrën e dorëzuar metodat e parashikuara për kryerjen e testimeve nuk parashikojnë një marzh gabimi fiks por një marzh gabimi të llogaritur në përqindje. Për këtë arsye për të qëndruara në të njëjtën linjë gjykojmë se edhe limitet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor duhet të shprehen në përqindje, përqindje kjo e përcaktuar në varësi të studimeve dhe metodave që parashikojnë ndryshimin e gramaturës së letrës nën ndikimin e faktorëve të jashtëm.

2. Në lidhje me kërkesën se *"pesha e letrës duhet të jetë 60 +/-2gr/m2"* kërkojmë të sqarohet nga autoriteti kontraktor nëse gramatura e letrës e parashikuar në specifikimet teknike duhet të jetë 60 +/-2gr/m2 letër e përpunuar apo letër e papërpunuar, pasi kërkojmë të sqarohet se letra në momentin që shtypet/perpunohet ndryshon gramaturën e saj dhe për të evituar çdo mundësi interpretimi kërkojmë që të sqarohet kjo nga autoriteti kontraktor.

II. Në lidhje me kërkesën se *"Bardhësia duhet të jetë mbi 80%"*, për të shmangur çdo paqartësi së pari kërkojmë të sqarohet nga autoriteti kontraktor nëse kjo përqindje bardhësie kërkohet vetëm për letrën 60 gr/m2 apo për të gjithë mallrat objekt prokurimi, pra edhe për kartonin 200-250 gr/m2 ?

Së dyti, në lidhje me kërkesën që *"Bardhësia duhet të jetë mbi 80%"* kërkojmë të sqarohet se nga verifikimet e kryera nga shoqëria jonë na rezulton se në territorin e Republikës së Shqipërisë nuk ka asnjë laborator të akredituar për kryerjen e testeve përsa i përket bardhësisë së letrës, dhe gjujmë se autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë një kriter i cili në thelb nuk mundet të verifikohet as nga AK nëse përmushet ose jo nga operatorët ekonomik pjesëmarrës.

Në gjykimin tonë vendosja e një kriteri të tillë që është praktikisht i pamundur që të verifikohet jo vetëm që do të sillte abuzime dhe keqinterpretime por nisur nga raste të mëparshme të ngjashme vendimesh të Komisionit të Prokurimit Publik do të sillte edhe anulimin e procedurës së prokurimit.

Për këtë arsye, për aq kohë sa në territorin e Republikës së Shqipërisë nuk ka asnjë laborator të akredituar për kryerjen e testeve përsa i përket bardhësisë së letrës kërkojmë heqjen e kërkesës së mësipërme si një kërkesë e cila cila jo vetëm që do të krijonte hapësira për interpretim por gjithashtu mund të sillte si pasojë edhe anulimin e procedurës së prokurimit.

- III. Në lidhje me kërkesën se mallrat objekt prokurimi duhet "Të jenë me logon e Posta Shqiptare Sh.A", për të evituar çodo paqartësi apo keqinterpretim kërkojmë të na sqarohet nga autoriteti kontraktor nëse për mostrat që duhet të dorëzohen të parashikuara në pikën 2.3.6 të "Kritereve të Veçanta të Kualifikimit", logo e Posta Shqiptare Sh.A duhet të jetë me ngjyra apo në cilësinë e mostrës nuk përbën kusht skualifikues edhe nëse logo do të jetë bardh e zi ?
- IV. Pasi morëm në shqyrtim specifikimet teknike të përocedurës së prokurimit objekt ankimi konstatojmë se për të gjithë mallrat objekt prokurimit autoriteti kontraktor ka parashikuar përmasa fikse të tyre. Në gjykimin tonë për aq kohë sa për produktet e letrës parashikohet gjithmonë një limit si përmasa i përket gramaturës së letrës gjithashtu edhe përmasa i përket përmasave rrjedhimisht autoriteti kontraktor duhet të parashikojë përmasa me një limit/diferencë të caktuar nga ato të kërkuara dhe jo përmasa fikse siç janë kërkuar në rastin konkret për të gjithë mallrat objekt prokurimi.

Gjithashtu për aq kohë sa nga verifikimet e kryera nga shoqëria jonë na rezulton se në territorin e Republikës së Shqipërisë edhe përmasa i përket testimit të përmasave të letrës nuk ka asnjë laborator të akredituar për kryerjen e këtyre testeve, vlerësojmë se vendosja e një kërkesë të tillë e cila parashikon përmasa fikse do të krijonte hapësira për abuzime dhe keqinterpretime, dhe vlerësojmë se autoriteti kontraktor në pamundësi për të hequr një specifikim të tillë pasi është një specifikim i rëndësishëm për realizimin e mallrave objekt prokurimi, **duhet të kërkojë përmasa me një diferencë të caktuar dhe jo përmasa fikse.**

3. Kërkesë për ekspertizë të posacme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

4. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

JO

5. Lista e informacionit konfidencial:

N/A

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes :Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik.**
Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/ Përfaqësuesi i autorizuar

Ervin Rroshi (Administrator)

ALBDESIGN PSP
Rr. Çerçiz Topulli, 17 - Kashar, Tiranë
NIPT: L51819005Q